

## Shendetit ne Udhetim SH.U dhe TPL ( O-ETR-673 )



### SHENDETI NE UDHETIM SH.U

Ky siguracion eshte gjithmone i keshillueshem te perdoret ne çdo udhetim tuajin, pasi ofron shperblim ne rastet kur ju mund te aksidentoheni jashte territorit shqiptare.

Perpara se ju te udhëtoni jashte vendit, ju keni nevojë për një siguracion të shendetit në udhëtim, i cili mbulon të gjitha shpenzimet mjeksore, spitalore, nderhyrjet kirurgjikale qe mund te lindin nga aksidente te ndryshme ose situata emergjence.

### Shëndeti në udhëtim

Kjo policë është hartuar për t'ju ardhur në ndihmë personave që udhëtojnë jashtë vendit duke asistuar në mbulimet e mëposhtme.

### Kushtet e përgjithshme të sigurimit të shëndetit në udhëtim:

#### Shpenzimet Mjeksore:

Shpenzime për ndihmë të shpejtë mjeksore-spitalore të kryera si pasojë e një gjëndje të papritur dhe të paparashikueshme acute, e cila pa trajtim mjeksorë brenda 48 orëve të shfaqjes së saj do të shkaktonte vdekjen ose probleme serioze të të siguruarit.

#### Shpenzimet e riatdhesimit:

- Siguruesit do të paguajnë për qiranë e një mjete transporti ose të një ambulance ajrore ose përdorimin e linjës së rregullt ajrore përfshi shoqëruesit e kualifikuar të vërtetuar sit ë nevojshëm nga mjeku dhe të autorizuar nga nga Siguruesi për riatdhesimin e një personi të sëmurë apo të dëmtuar seriozisht.
- Shpenzimet funerale jashtë teritorit të shqipërisë dhe/ose kostojae transportit të kufomës apo hirit të personit të siguruar për në vëndin e banimit të treguar në Police, nëse ai vdes brenda periudhës së sigurimit.
- Shpenzimet e riatdhesimit do të paguhen nëse vdekja e personit ka ardhur si rezultat I një sëmundje që plotëson kushtet e mbulimit sipas kontratës së sigurimit.

### Dëmshpërblimi për aksidentet personale:

Në rast dëmtimi trupor shkaktuar vetëm dhe drejtpërdrejtë nga mjete aksidentale, të dhunshme, të jashtme dhe të dukshme që ka pësuar një Person i Siguruar gjatë periudhës së sigurimit do të paguhen dëmshpërblimet si mëposhtë:

- Vdekja aksidentale ose humbja e një apo më shumë gjymtyrëve thyerjet e kolonës të shoqëruara me hemiplegi ose paraplegji/humbja e shikimit në sy do të paguhet 10.000 Euro për secilën Zonë Mbulimi.
- Paafhtësia e përhershme e plotë do të paguhet 10.000 Euro për secilën Zonë të Mbulimit.
- Polica e shëndetit në udhëtim nuk mbulon shpenzimet për dëmet pasurore dhe jo pasurore që i shkaktohen të siguruarit por vetëm shpenzimet spitalore dhe farmaceutike sipas kushteve të kontratës së sigurimit të shëndetit në udhëtim.

### Sigurimin e automjeteve TPL

Pergjegjesine e mbajtesve te tij ndaj paleve te treta TPL - i detyrueshem per tu bere sipas ligjit ne fuqi, duke patur per qellim, pervec te tjerash, mbrojtjen e interesave financiare te te siguruarit kundrejt kerkesave per demshperblim qe vijne nga te pale



te treta te demtuara ne aksidente automobilistike.

Tarifat e primit te sigurimit jane te unifikuara per te gjitha shoqerite e sigurimit konform legjislacionit ne shqiperi. Per automjetet e regjistruara rregullisht - kontrata me afat 1 vit.

eTour.al